



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Državna Agencija za Zaštitu Ličnih Podataka
National Agency for Protection of Personal Data



Këshillë

Lidhur me ndryshimin e profilit dhe vjedhjet e ndryshme të identitetit në 'Facebook' dhe Internet

Një ndër rastet më të shpeshta të keqpërdorimit të të dhënave personale është ndryshimi dhe vjedhja e identitetit në internet. Raste të këtilla paraqiten kryesisht në faqen e rrjetit social 'facebook', duke krijuar profile të rrejshme. Përmes këtyre profileve të rrejshme, abuzuesit, si krijues të këtyre profileve, komunikojnë me rrjetin e miqve/personave, me të cilët, personat të cilëve u është ndërruar identiteti kanë pasur komunikimin e tyre. Ndërruesit e identitetit krijojnë lidhjet komunikuese në emër të personit të cilit ia kanë ndërruar identitetin dhe paraqiten e prezentohen në emrin e tij/saj, duke shfrytëzuar të dhënat personale të personit të cilit i është ndërruar profili pa dijen dhe pëlqimin e tij/saj. Lidhur me këto veprime të shkeljes së të dhënave personale dhe të privatësisë së qytetarëve të kategorive të ndryshme nga të gjitha grupet sociale, Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, këshillon të gjithë qytetarët të jenë të kujdesshëm gjatë përdorimit të internetit, duke sugjeruar që, sa u përket të dhënave personale, fotografive dhe të gjitha çështjeve tjera që kanë të bëjnë me jetën e tyre intime dhe private, të postohen sa më pak të dhëna, në mënyrë që t'u shmangen keqpërdorimit të mundshëm nga ndërhyrjet e paligjshme që shkaktojnë pasoja të paparashikueshme për qytetarët.

Gjithashtu, për raste të këtyre shkeljeve i njoftojmë të gjithë qytetarët që shqetësimet e tyre t'i adresojnë në adresën e Agjencisë www.amdp-rks.gov.